



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE KORÇË

Nr. 924/4_ Prot.

Korçë 10 / 08 / 2026

Lënda: Kërkesë për shpallje publike e aktit administrativ

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Bazuar në nenin 96 të Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenit 162/4 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kërkojmë shpalljen për **Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit**, si më poshtë:

Subjekti	NIPT/ Nr.identifikimi	Nr. vend imi	Data	Detyrim (leke)	Gjore (leke)	Shuma (leke)
ADMIRAL OIL	K54621001Q	677	29.06.2026	23 122 594	69 367 782	92 490 376

Për vijimin e procedurës për rikuperimin e borxhit konform nenit 280 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës” është domosdoshmëri evidentimi i datës së shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI DEGËS DOGANORE

Olsi EKONOMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE KORÇË

Nr. 677 Prot.

Korçë më, 29/06/2026

VENDIM

**Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor
të subjektit debitor "ADMIRAL OIL" me NIPT L04105003C**

Dega Doganore Korçë, me Vendimin Nr. 10 datë 10.04.2026 ka vendosur për subjektin "ADMIRAL OIL" me NIPT L04105003C të shpallet debitor për detyrim akcize 23122594 lekë dhe gjobë akcize 69367782 lekë. Ky vendim i është njoftuar debitorit me afishim publik të aktit. Subjekti ka marrë dijeni 30 ditë pas afishimit dhe nuk është arkëtuar vullnetarisht borxhi i papaguar brenda afateve ligjore. Në përfundim të afatit ligjor për pagim vullnetar duke qenë se subjekti debitor nuk ka arkëtuar borxhin sipas Vendimit nr. 10 datë 10.04.2026, duke mos pasur asnjë pengesë ligjore dhe me qëllim rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara prej subjektit debitor, në zbatim të nenit 280 të Ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 103 të Ligj nr. 61/2012, nenit 511 e vijues të K.Pr.Civile dhe Udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Dega Doganore Korçë,

VENDOSI:

- 1.Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumenta me anë të të cilëve bëhen pagesa, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit apo garantuesve;
- 2.Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që i përkasin debitorit apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit;
- 3.Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën e borxhit të papaguar **92 490 376 (nëntëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë)** lekë të pasqyruar në vendimin nr. 10 datë 10.04.2026 dhe kamatvonesat e përlllogaritura nga momenti i njoftimit të aktit administrativ e deri në momentin e likuidimit total.

Njëhësuar me origjinalin



KRYETAR I DEGËS DOGANORE

OISI EKONOMI